



# 7 Mars Lule për mësuesit

## 2021

Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë (KKAD) organizoi një takim online me rastin e 7 Marsit, Ditës së Arsimit dhe Shkollës shqipe, e njohur si Dita e Mësuesit.





# 7 Mars

# Lule për mësuesit

---

2021

Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë (KKAD) organizoi një takim online me rastin e 7 Marsit, Ditës së Arsimit dhe Shkollës shqipe, e njohur si Dita e Mësuesit.



## «LULE PËR MËSUESIT»



Edhe ky 7 Mars sjell freskinë e duhur për të shfletuar faqet e historisë, faqet e arsimit shqip, kudo ku mësuesit shqiptarë mbollën shkronjat e gjuhës shqipe. Shkronja, të cilat u kanë bërë dhe u bëjnë ballë pushtimeve më të egra, pandemive dhe situatave të ndryshme, të cilat rënduan dhe rëndojnë frymëmarrjen shqiptare.

Kolegë të nderuar, kudo ku jeni, kudo ku kontribuoni në shërbim të gjuhës dhe shkollës shqipe, në pamundësi për të qenë në një takim të përbashkët me rastin e "7 Marsit - Ditës së Mësuesit", Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë (KKAD) ju fton në një takim virtual,

me datën 5 mars 2021, në orën  
19:00, sipas orës së Tiranës

Të festojmë së bashku, të ngjallim shpresë te brezat e rinj, të jemi bashkë në shenjë përkujtimi të mësuesve që mbajtën gjallë gjuhën shqipe ndër shekuj.

Gëzuar 7 Marsin - Ditën e Mësuesit!

Këshilli Koordinues i Arsimitarëve  
në Diasporë (KKAD)  
Dr. Vaxhid Sejdiu-kryetar

## Përmbledhje rreth TAKIMIT

Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë (KKAD) organizoi një takim virtual (online) me të gjithë mësimdhënësit e mërgatës shqiptare, ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues institucionalë të dy shteteve tona shqiptare.

Takimin e hapi Kryetari i KKAD-së, dr. Vaxhid Sejdiu, i cili përshëndeti të pranishmit, duke u uruar festën e 7 Marsit. Më tej z. Sejdiu tha: “Sot, më 7 Mars 2021, duke ju dëshiruar të gjithëve shëndet dhe një ditë të mbarë, kam edhe një urim të veçantë për të gjithë ata, të cilët kanë punuar dhe punojnë në shërbim të shkollës shqipe. Gëzuar! Paçi forcë, guxim dhe atdhedashuri tërë jetën, sepse ATDHEU ka nevojë për ju. “Heronjtë” e diturisë janë ata, të cilët ngjallin shpresë, nxisin përkushtim dhe hapin shtigje të reja për një të ardhme më të mirë të kombit”.

Takimin e përshëndeti edhe drejtori i Institutit Albanologjik i Republikës së Kosovës, dr. Hysen Matoshi, drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën e Republikës së Shqipërisë, dr. Mimoza Hysa, dhe sekretarja e KKD-së nga Kanadaja, prof. dr. Adriana Bejko.

Pjesën teknike dhe organizimin e bëri Mustafë Krasniqi, Enela Markja, Milazim Ukaj nga LAPSH-i në Bavari-Gjermani, ndërsa moderimin e bëri Mira Shehu, të shoqëruar me Këshillin organizues të KKAD-së Mustafë Krasniqi, Aurela Konduri, Dritan Mashi, Miradije Berisha dhe Teuta Tabaku.

Takimi përfundoi me përshëndetjen e mësimdhënësve. Njëkohësisht për të gjithë ata që nuk patën mundësi dhe dhanë opinionet e tyre me shkrim, së shpejti sektori i informimit do t'i publikojë në një libër elektronik, tha dr. Vaxhid Sejdiu.

## Të pranishëm në takim

Boralda Kuci  
Zyrifa Gecaj-Kqiku  
Alma Zekollari  
Yllka Alidema  
Eleni Spahiu  
Klarita Selmanaj  
Driton Kajtazi  
Manjola Xhajanka  
Mimoza Leka  
Marjana Shollo  
Eriketa Qorlazja  
Tana Spirollari  
Mendu Imeri  
Shkelqim Delia  
Esonela Zekthi  
Tana Laci  
Mimoza Sali  
Aleksandra Nikollo  
Mimoza Mustafa  
Aurora Minga-Celiku  
Madalena Peshtani  
Irma Katerina Zaka  
Ardjan Shaqiri  
Imer Ademi  
Lindita Vendresha  
Danila Sfaga  
Teuta Dervishi  
Zerko Beqiri  
Vera Brozi  
Drenusha Istogu  
Sonila Otabashi  
Emanuela Ymeri  
Flamur Biçaku  
Valbona Roqi  
Alma Papamihali  
Drita Gjongecaj  
Esmeralda Sadiku  
Aferdita Marku  
Julia Misini  
Fatmire Bunjaku  
Elida Halilaj  
Zhuljeta Hysolli Kobellari  
Luiza Muho  
Klodiana Vilza  
Drane Dedaj  
Alketa Kambo  
Valbona Toci  
Majlinda Gjoka

Drita Vasili  
Dhurata Tusha  
Keti Bandilli  
Diti Gashi  
Lindita Budini  
Luljeta Nuraj-Koubati  
Gladiola Sadiku  
Ekloida Sula  
Sadete Halilaj  
Flora Andona Sallabanda  
Diana Hanxhari  
Merita Isufi Avdyli  
Bruna Laska  
Violeta Skopeci  
Pjerin Lleshi  
Valbona Mara  
Aida Haziri  
Ilira Ndrio Bakalli  
Rovena Vata  
Edita Krasniqi  
Rezearta Dizdari  
Antoriata Cirongu Hysolli  
Hamez Dakaj  
Blerina Morina Shabani  
Antoneta Micalliu  
Qemal Zylo  
Blerta Canaj  
Enilda Ganolli Progmi  
Leonora Zefi  
Etleva Mançe  
Ragip Thaqi  
Lefteri Metkaj  
Dila Rrapi  
Zana Gjonbalaj  
Gerti Xhaja  
Xhevat Isufi  
Eva Paloka  
Renata Durro  
Irena Alushani  
Silvana Mile Agolli  
Elvira Beshaj  
Osman Ademi  
Kristina Roshi  
Majlinda Lipi  
Rizah Sheqiri  
Silvana Dogani  
Blerta Hoxha



## Gëzuar festën e 7 Marsit!

Sot, më 7 Mars 2021, duke ju dëshiruar të gjithëve shëndet dhe një ditë të mbarë, kam një urim të veçantë për të gjithë ata, të cilët kanë punuar dhe punojnë në shërbim të shkollës shqipe. Gëzuar! Paçi forcë, guxim dhe atdhedashuri tërë jetën, sepse ATDHEU ka nevojë për ju. “Heronjtë” e diturisë janë ata që ngjallin shpresë, nxisin përkushtim dhe hapin shtigje të reja për një të ardhme më të mirë të kombit. Mësuesit në vazhdimësi kanë qenë shembulli më mirë i sakrificës dhe angazhimit kombëtar. Ata që ruajnë shkronjat e shqipes dhe i përcjellin me një dashuri të veçantë te më të vegjlit, që nesër janë e ardhmja jonë, meritojnë respekt jo vetëm në këtë ditë festive. Si zakonisht tema e një feste na përcakton se çka të themi dhe si t'i formulojmë fjalitë. Por unë do të bëj një përjashtim duke e vënë theksin te mësuesit e mërgatës shqiptare, të cilët, edhe pse në kushte të pabarabarta me kolegët e tyre ku ata veprojnë dhe punojnë, vazhdojnë misionin e tyre me përkushtim, që të mbjellin sa më shumë dashuri për gjuhën shqipe. Dhe kjo dashuri përfshin në gjirin e vet fëmijët e mërgimtarëve tanë, të cilët lindin dhe rriten larg atdheut, por me një përkushtim të veçantë ndaj gjuhës së nënës.

Kolegë të nderuar, ju jeni ata që me punën tuaj ngjallni shpresë në ruajtjen e identitetit kombëtar, gjuhës dhe kulturës kombëtare. Ju lumtë!

Sot, për dallim nga vitet e kaluara, kësaj feste i bashkëngjitet edhe Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë (KKAD), i cili me punën dhe angazhimin e tij arriti t'i bindë institucionet tona se një bashkëpunim me ne ia vlen, në shërbim të organizimit sa më të mirë të shkollës shqipe në mërgatë. Në fund të urimit mund të themi se sa herë që marrim rrugën bashkërisht nën flamurin kombëtar dhe gjuhën shqipe dalim gjithmonë faqebardhë.

Prandaj nga zemra ju uroj Gëzuar! Gëzuar 7 Marsin - Ditën e Mësuesit!

Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë (KKAD)  
Dr. Vaxhid Sejdiu, kryetar

## Fjala e hapjes

Znj. Mira Shehu

Të nderuar mësues, pjesëmarrës në aktivitet, ju uroj mirëseardhjen dhe gëzuar festën e 7 Marsit! Ne mësuesit na bashkon dashuria për gjuhën e kulturën tonë dhe përkushtimi që këtë gjuhë të vyer t'ua transmetojmë brezave të rinj në diasporë. Do të doja që një tufë me lule plot mirënjohje e respekt për punën tuaj fisnike t'ua jepja sot nga ana tjetër e oqeanit duke ju uruar vetëm suksese. Faleminderit dhe le të gëzojmë së bashku ditën tonë këtë vit e shumë të tjerë së bashku.

### Nxënësit që përshëndetën:

Ambra Bardhoci  
Era Ere  
Adina Zdruli  
Det Ramosaj  
Zana Shala  
Lir Shala  
Anisa Shala  
Aurora Doko

### Pjesëmarësit zyrtarë:

Dr. Hysen Matoshi  
Dr. Mimoza Hysa Culiqi  
Dr. Adriana Fishta Bejko

# Vaxhid Sejdiu

E nderuara drejtoreshë e QBD-së, znj. Hysa Çuliqi,  
I nderuar drejtor i Institutit Albanologjik në Prishtinë, z. Matoshi,  
Të nderuar kolegë,

Më lejoni që në emër të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës t'ju dëshiroj mirëseardhjen në këtë takim të përbashkët me rastin e festës së 7 Marsit - Ditës së Mësuesit.

Natyrshëm mund të pyesni si lindi ideja për këtë takim? Ideja ishte e thjeshtë; lindi në kuadër të Këshillit, me qëllim që në këtë kohë mjaft të vështirë për të gjithë ne, por me dëshirën më të madhe, të bëhemi bashkë dhe ta motivojmë njëri - tjetrin në punën dhe angazhimin tonë kombëtar. Për një çast të jemi së bashku, për një çast të themi kemi forcë për t'i shërbyer gjuhës, shkollës dhe kulturës kombëtare.

Të nderuar pjesëmarrës,

Në raste të këtilla ka shumë për të thënë, sepse festat kombëtare na detyrojnë të kthejmë kujtesën dhe të shohim se sa dhe se çka kemi bërë, por, në mungesë të kohës, unë do të mundohem që nëpërmjet disa copëzave të nxjerr portretin e tashëm dhe të ardhshëm të shkollës shqipe në mërgatë.

E para, përgëzoj të gjithë kolegët në mbarë botën, të cilët me punën e tyre i shërbejnë gjuhës dhe kulturës kombëtare, edhe pse shpeshherë në kushte të pabarabarta me kolegët në vendet në të cilat veprojnë.

E dyta, përpjekjet e ditëve të sotme, edhe pse në kohë pandemie, dëshmojnë nivelin e përgjegjësisë të të gjithë mësuesve, me qëllim që të përfshijmë sa më shumë fëmijë shqiptarë në orët mësimore të gjuhës amtare.

E treta, koha kërkon ndryshime, ndryshime në shërbim të njehsimit të shkollave shqipe; koha kërkon bashkim të të gjitha forcave, por në rend të parë të mësuesve kudo ku janë, me qëllim që kërkesat tona në të ardhmen të jenë më të realizueshme.

Parashtrohet pyetja se a ballafaqohet organizimi i mësimit plotësues në mërgatë me vështirësi? Natyrisht që po. Me vështirësi përballet çdo gjë në jetë, por duhen bërë përpjekje për t'i tejkaluar ato.

Tani ndokush mund të thotë: ja vitet po kalojnë, problemet janë po ato. Por unë dhe kolegët e mi, me të cilët kemi punuar kohët e fundit, e themi pak më ndryshe. Ngjallim shpresë. E vërtetë se problemet e akumuluar me vite nuk mund të zgjidhen brenda natës, por, nëse bëhemi bashkë, gjendja mund të ndryshohet.



Këto pohime mund t'i ilustroj me fakte:

1. E para, para 3-4 viteve në Zvicër ishte e pamundur të hapej një shkollë tjetër. Edhe pse sistemi i vjetër kishte filluar të degradonte, ne, një grup mësuesish, në bashkëpunim me Ambasadat tona të Shqipërisë dhe të Kosovës, arritëm ta ndryshojmë gjendjen. Me një punë të vazhdueshme dhe bindëse me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë arritëm brenda një afati të shkurtër prej një viti e gjysmë të kemi rezultate të dukshme. Nga gushti i vitit 2019 dhe deri më sot kemi hapur 44 shkolla të reja me 678 nxënës gjithsej dhe, në javët në vazhdim, pritet të hapen edhe 23 shkolla të tjera. Jam i bindur që deri në fund të vitit do ta shohim nxënësin e 1000-të me abetare në dorë.

2. E dyta, me përpjekjet e profesorëve të nderuar Adriana Bejko dhe Sokrat Sinaj dhe me mirëkuptimin e dhjetëra mësuesve të përkushtuar arritëm të themelojmë fillimisht Këshillin e Mësimit Shqip për Diasporën, që sot mban emrin KKAD.

3. Lind pyetja, a ishte i lehtë ky rrugëtim? Natyrisht që nuk ishte i lehtë, por me një punë të vazhdueshme gjatë këtyre 10 muajve arritëm t'i bindim institucionet tona, në veçanti Ministrinë e Diasporës, por edhe qeverinë shqiptare, se një bashkëpunim me Këshillin e Mësimit Shqip ia vlen.


4. Që nga fillimi, qëllimi ynë ishte të merrnim mbi vete përgjegjësinë (së bashku me institucionet tona përkatëse) për një mësimdhënie të njehsuar e të koordinuar, gjë që u bë edhe me një VKM të veçantë, e cila na mundëson që të jemi palë konsultuese për problematikat në fushën e njehsimit të shkollave shqipe në diasporë.

5. Vizioni ynë ishte që të përfshiheshim në hartimin e teksteve dhe zgjedhjeve didaktike, për të siguruar kompetencat e nevojshme gjuhësore dhe kulturore, dhe sot jemi me të drejtë palë konsultuese.

6. Ngritëm zërin dhe thamë qartë dhe pastër se na mungojnë tekstet shkollore të përshtatshme për fëmijët e diasporës, por jo vetëm këto.

Iu drejtua Ministrisë së shtetit shqiptar dhe veçanërisht QBD-së me kërkesat tona. Dhe ditë më parë u arrit të nënshkruhet edhe marrëveshja për hartimin e teksteve shkollore Shqipëri - Kosovë. Unë e kam thënë dhe po e them se ky është lajm për të gjithë ne. Pa njehsimin e shkollave shqipe në mërgatë nuk mund të themi se kemi shkollë shqipe të organizuar.

7. Për gjithë këtë aktivitet, falënderoj në rend të parë Ministrinë e Diasporës së Shqipërisë dhe atë të Kosovës, konkretisht ministrin z. Majko, si dhe drejtoreshën e QBD-së znj. Hysa, të cilët së bashku me të gjithë bashkëpunëtorët u angazhuan në shërbim të arsimit shqip në diasporë.



8. Objektiv kryesor ishte dhe është të krijojmë një urë bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet mësuesve të të gjitha shkollave dhe bashkëkombësve që jetojnë jashtë kufijve të trojeve shqiptare në diasporë.

9. Dhe e fundit, historikisht gjërat kombëtare kanë filluar nga mërgata. Do të ishte mirë që, së pari, të bashkohemi ne mësuesit, ashtu siç jemi nga të gjitha trojet shqiptare, dhe të veprojmë me gjithë forcën që kemi, t'i lëmë meritë dhe analizat e panevojshme, t'i përvishemi punës, sepse e kemi thënë dhe po e përsëris:

Së bashku mundemi!

Ju faleminderit!



## Prof. dr. Hysen Matoshi

Drejtor i Institutit Albanologjik në Kosovë

Përshëndetje! Gëzuar festën e 7 Marsit të gjithë mësuesve anembanë botës, kudo mësuesve shqiptarë! Puna juaj është vërtet një punë e pashembullt e përkushtimit të rrallë, sepse arrini të mbani të gjallë gjuhën, kulturën, identitetin e fëmijëve tanë në vende të ndryshme të botës. Personalisht kam punuar si mësues dhe vazhdoj edhe sot. E di që është një nga punët më të shenjta e më të vlefshme të njerëzimit, veçmas kjo për kombin tonë, meqë dimë se nga arsimi, nga shkollat, nga ndërgjegjësimi rrodhi ndërgjegjësimi kombëtar. Unë do t'ju përshëndes të gjithëve: Këshillin Koordinues të Arsimtarëve të Diasporës, kryetarin z. Vazhid Sejdiu dhe të gjithë pjesëmarrësit e këtij asosacioni, në mënyrë të veçantë ish-kolegun tim, shokun e klasës, Mustafë Krasniqi, me të cilin kemi qenë bashkë në shkollën e mesme.

Shkolla shqipe në mërgatë, në diasporë në përgjithësi është një nga problemet më të vështira dhe më të pazgjidhshme për institucionet, mendoj për të dy vendet, të cilat kanë bërë fare pak.

Në vitin 2013, kur miratohej strategjia për mërgatën shqiptare, ne u ftuam si Institut që të jemi pjesë e saj dhe, natyrisht, Instituti Albanologjik pati një fokus te identitetit i mërgatës sonë, veçmas te identiteti i brezit të ri, i cili s'ka si të ruhet veçse nëpërmjet shkollës së gjuhës amtare. Ne gëzohemi shumë kur të rinjtë tanë, fëmijët tanë dhe studentët shqiptarë arrijnë rezultate të jashtëzakonshme në vendet pritëse, kur identifikohen me arritje më të larta krahas qytetarëve vendës të vendit. Por edhe më shumë na gëzon fakti që rrënjët e tyre nuk janë shkëputur nga e kaluara e tyre, nga identiteti i tyre, nga familja, nga kombi dhe kur ata mbesin të lidhur përherë.

Kemi rastin të presim në Institutin tonë të na vijnë studentë, nxënës të mërgatës, arsimtarë dhe do të vazhdojmë t'i presim po kështu në të ardhmen me këtë lloj mikpritjeje e dashurie. Natyrisht, sa herë të kërkohet, qoftë për hartimin e teksteve, qoftë për hartimin e programeve, planprogrameve mësimore, kurrikulave mësimore që lidhen me mërgatën, Instituti Albanologjik -që ka një numër të madh studiuesish, gjuhëtarësh, letrarësh, historianësh, folkloristësh, etnologësh, etnomuzikologësh, arkeologësh- do të përzgjedhë vlerat më të mira të mundshme për nxënësit tanë dhe të përshtatshme natyrisht, në mënyrë që të ruhet komunikimi i tyre me kulturën

rrënjësore të tyre, me origjinën dhe identitetin e tyre, duke mos i penguar fare që edhe në gjuhën vendëse të vendeve ku janë të arrijnë suksese të shënuara.

Jam vërtet shumë i nderuar që këtë 7 Mars, Ditën e Mësuesit, si dhe në prag të përkujtimit të Epopesë heroike të familjes Jashari dhe të Epopesë së UÇK-së ta shënoj me ju, t'ju shoh. Për mua është privilegj.

Vërtet ju uroj nga zemra! Ju meritoni lulet më të bukura të atdheut si mësues që shpërndani gjuhën shqipe, që u komunikoni gjuhën shqipe fëmijëve tanë anekënd botës.

Ju faleminderit shumë!

## Mimoza Hysa

Të nderuar anëtarë të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, ndihem shumë e nderuar që ndodhem sot midis jush për këtë festë të veçantë.

Në këtë ditë më vjen ndër mend një libër i veçante për edukimin dhe rolin e mësuesit i shkruar një shekull më parë nga De Amicis me titullin kuptimplotë “Zemra”. E pikërisht nga zemra nis edhe edukimi.

Është zemra çelësi që i hap mendjen, asnjë punë, asnjë detyrë, sidomos në fushën e arsimit nuk mund të bëhet pa dashuri, pa pasion.

Ky është mësimi i parë që një mësues i mirë me shembullin e tij ia përcjell nxënësit që në ngjizje. Meqë e nisa nga zemra dhe nga gjerat më personale më vjen të uroj së pari në këtë ditë nënën time që ka dhënë mësim shumë herët dhe është një ndër veteranet e mësimin në qytetin e Tiranës.

Po këtë mësim unë ia kam dhënë dhe nxënësve të mi për një dekadë të tërë sepse unë e kam nisur rrugëtimin tim pikërisht me këtë mision të bukur dhe të nderuar dhe kjo është gjithashtu edhe një arsye më tepër që më bën të jem e nderuar që sot drejtoj Qendrën e Botimeve për Diasporën që ka si mision mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në mërgatë dhe të kem mundësinë tu shërbej më shumë se 500 mësuesve që japin shërbim jashtë vendit.

Puna e mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë, puna juaj është më tepër mision që merr vlerë të veçante për disa arsye. Ju keni mundësinë sot të ushqeni ndjenjat e atdhedashurisë të fëmijët shqiptarë jashtë vendit, duke i bërë ata të përgjegjshëm se mësimi i gjuhës shqipe është vlerë e shtuar, është plotësim i identitetit të tyre dhe është ndihmese e të nxënësve edhe të gjuhëve të tjera edhe të kulturave të tjera në vendet ku jetojnë. Ju sot keni mundësi të mësoni të ndiheni krenarë për vendin e prejardhjes dhe se e kanë ata në dorë të lartësojnë vendin e origjinës përmes lartësimit të vendit të tyre ju keni mundësinë të vini ura komunikimi mes vendeve ku jetoni dhe atdheut tuaj, duke kontribuar për një marrëdhënie më të shëndetshme kudo ndodheni.

Kur flas për bashkëpunim, flas për shkëmbimin e çdo gjëje të mirë dhe të vyer që kemi mes njëri tjetrit ne si bashkatdhetarë por edhe me të huajt në vendet ku jetoni.

Gjuha jonë dhe kultura shqiptare është ndër gjërat më të vyera që kemi e që mund ta shfrytëzojmë pikërisht si bazë të fortë për të forcuar këtë bashkëpunim.

Ne jemi një komb që mund të dëshmojmë më së miri se vendosja e kufijve, mbyllja, përçarja e kacafytja mes njëri tjetrit, apo vendosja e barrierave përkthehen në varfërim, në mjerim për vetë ne së pari, përkthehen në luftë, në humbje, në dështim. Një shembull bashkëpunimi këtë herë institucionet tona shqipfolëse, Shqipëria dhe Kosova e dhanë me përmbylljen e procesit të teksteve të përbashkëta në diasporë. Është vetëm hapi i parë që nëpërmjet unifikimit të teksteve do të vijë më pas dhe unifikimi i mësimdhënies. Zbatimi i pikave të marrëveshjes me Kosovën sapo ka nisur dhe kur këtë gjë e arrijnë institucionet ku burokracia dhe procedurat janë edhe më të vështira, është më e lehtë dhe më e thjeshtë që ky bashkëpunim të vendoset edhe midis komuniteteve të mësuesve kudo që shërbejnë dhe të vazhdojë më pas në komunitetet tona, shoqatat, të përcillet te brezi i ri që po edukohet në mërgim.

Kjo cilësi e vyer është edhe në themelet e qytetarisë së shteteve demokratike ku shqiptarët jetojnë sot. Politika e qendrës që unë drejtoj e ka bazën në parimin e saj bazë pikërisht bashkëpunimin si në institucionet e tjera në Kosovë, si dhe me mësues e shoqata kulturore, duke respektuar kështu edhe punën e vyer të gjithsecilit. Falë këtij bashkëpunimi është arritur këtë vit edhe krijimi i këtij këshilli të arsimtarëve në Diasporë, që e quaj një arritje shumë të madhe me qëllim unifikimin e mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. Në përbërjen e këtij këshilli ka mësues nga Shqipëria, Kosova dhe trevat e tjera shqipfolëse, dhe unë besoj se ka një mision shumë të rëndësishëm që duke u bërë së bashku, ashtu sikurse tha edhe z. Vaxhid do të arrijmë të gjitha qëllimet.

Veçova vetëm këto dy bashkëpunime të rëndësishme të këtij viti mes institucioneve tona dhe mes vetë shqiptarëve në diasporë, për të kuptuar se misioni ynë i përbashkët, ai i ruajtjes së gjuhës, trashëgimisë kulturore shqiptare është thelbi që na bën bashkë në këto hapa të rëndësishëm janë bërë bashkë ministritë e arsimit të dy vendeve, ministritë e diasporës, ministritë e jashtme, duke përmendur këtu institucione. Ndërkohë në diasporë janë bërë bashkë shqiptarë nga të gjitha trojet. Ky në fakt ishte dhe në nga vitet më të vështira për ne, për njerëzimin dhe për mësimdhënien.

Përveç detyrës së mbajtjes gjallë të gjuhës shqipe, mësuesve në diasporë ju është dashur të ndeshen edhe me krizën e vetmisë së thellë të nxënësve të tyre, me pamundësinë të zhvillimit së bashku të orës së mësimi. Ju është dashur të ndihen të pranishëm te nxënësit për të bërë sa më të përballueshme këtë situatë.

Do doja të sillja këtu një imazh shumë të bukur të një autori, meqenëse letërsia është linja që më ka ushqyer gjithë jetën dhe që përbën dhe profesionin tim kryesor. Një imazh i Calvinos, shkrimtarit italian në “leksionet amerikane”, kur flet për lehtësinë dhe vështrimin e Perseut. Heroi vështronte botën përmes mburojës dhe kjo e lehtësonte të shihte në sy Meduzën pa u kthyer në gur.



Për këtë gjë shërben kultura, shkolla. Për të parë në sy realitetin e vështirë dhe kur na vret. Qoftë edhe një situatë si kjo që po jetojmë, por pa na ngurtësuar shpirtin tonë. Dija, edukimi është mburoja jonë që na bën të përballojmë të keqen dhe të mbetemi humanë. Na bën që të mbajmë zemrën gjallë.

E nisa në fillim duke thënë për zemrën e De Amicis dhe pikërisht me këtë zemër po e mbyll, që është çelësi që na çon drejt dijes, por dhe dija është çelësi që na e mban gjallë zemrën. Kjo është një lidhje e fortë, e pandashme që pikërisht arsimi i bën të dyja bashkë. Ju përgëzoj për çdo gjë që bëni.

Uroj që hapi i ndërmarrë nga qeveria jonë për njohjen e punës tuaj, mbështetja e mësimdhënies nëpërmjet teksteve, literaturës shtesë, projekteve të jetë vetëm hapi i parë që do pasojë shumë të tjerë.

Ju falënderoj dhe gëzuar këtë ditë të rëndësishme për ju dhe për të gjithë ne.

## Prof. Dr. Adriana Bejko

Të nderuar kolegë,

E fillova përshëndetjen, së pari, me kolegët, pasi kjo është Dita e Mësuesit.

Gjithashtu, më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të mira nga Këshilli Koordinues i Diasporës, si dhe mirënjohjen për këtë takim në prag të 7 Marsit.

Dëshira dhe vullneti i mirë për të konsideruar ruajtjen e gjuhës shqipe në diasporë nuk janë një risi për ne. Në mënyrë të veçantë, këto dy vitet e fundit është vënë re që çështjet e diasporës janë bërë përparësi për institucionet përkatëse, në mënyrë të veçantë e KKAD-së, ndërsa për çështjet e mësimit shqip në veçanti Ministria e Arsimit po jep kontribut të dukshëm.

Këtu do të theksoja ndërtimin e një infrastrukture ligjore të saktë që po vendos në shina ligjore, linguistike, didaktike dhe shkencore mësimin e gjuhës shqipe në diasporë. Si vendime shumë të rëndësishme mund të përmendim miratimin e KKD-së, ndërtimin i grupit të edukimit dhe, së fundmi, miratimin e KKAD-së dhe nënshkrimin e dokumenteve të përbashkëta për hartimin e teksteve nga të dy ministrat e Arsimit në Kosovë dhe në Shqipëri. Gjithashtu, përfitoj nga rasti të shpreh mirënjohjen për mbështetjen me tekste shkollore të dërguara nëpërmjet ambasadave, si dhe kontributin dhe bashkëpunimin e ngushtë me QBD-në.

Historikisht mërgata shqiptare ka bërë shumë përpjekje për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kudo në botë duke i rezistuar asimilimit në kulturat e vendeve pritëse. Ne respektojmë shumë punën e bërë nga kolegët paraardhës, por mendojmë që është koha të fillojmë një kapitull të ri shkencor dhe të kalojmë nga stadi i kurseve të gjuhës shqipe në një sistem të vërtetë shkollash, ku mësimdhënia të jetë unike dhe e strukturuar mbi baza shkencore si nga ana linguistike, ashtu edhe nga ajo didaktike.

Tani më lejoni të flas si mësuese me një përvojë 46-vjeçare në tre kontinente dhe shumë shtete të botës si hartuese e politikave arsimore apo si pedagoge në fakultetet e mësuesisë. Për një gjë dua t'ju siguroj se askund nuk kam gjetur mësues më të mirë se mësuesit shqiptarë.

Ndihem shumë e privilegjuar që të jem pjesë e këtij grupi kolegësh sa të nderuar, aq edhe me përkushtim për të ndihmuar fëmijët kudo në botë.

Ditën e parë të leksionit me studentët e mësuesisë në Amerikë apo në Kanada unë e filloj me fjalët: Prindërit na besojnë gjënë më të shtrenjtë që kanë - BEBET e tyre, pra mësuesia është një kombinim i dashnisë me shkencë, art dhe mision. Para se të vendosni përfundimisht të bëheni mësues, bëjini vetes dy pyetje: A jam gati t'u mësoj fëmijëve si të lidhin këpucën apo t'i ndihmoj të veshin xhaketën? A jam gati t'u fshij hundët kur janë me rrufë? Kjo e ndan MËSUESIN dhe atë që shkon në punë për rrogën. Dhe ju të nderuar kolegë jeni të gjithë MËSUES.

Meqenëse e ndiej veten si mësuese veterane dhe me fatin e madh që shumë nga nxënësit e mi janë bërë më të mirë se mësuesja e tyre, që nga nënkryetarja e parlamentit, te rektori i universitetit dhe te një numër i madh akademikësh që dikur janë ulur në klasën time në gjimnazin “Qemal Stafa”, do të më lejoni të flas me pak romantikë të tipit të rilindësve tanë. Shpesh herë kur dëshpërohem pse disa prindër nuk i sjellin fëmijët në shkollat tona apo pse disa kolegë, të cilët nuk janë të këqij por sillen të ndikuar nga meritë e vogla ballkanike, nuk dinë të thonë *Gëzohem për ty!*, u kthehem thënieve të rilindësve dhe luftës së tyre për ruajtjen e gjuhës shqipe:


*“Mblidhmani gjakun se do t'u duhet fëmijëve për të shkruar fjalët e shqipes”...*

Këto fjalë të arta tha mësuesi Petro Nini Luarasi dhe mbeti në historinë e mësimit shqip si një mësues i përjetshëm, mbeti mësuesi monument i shkronjëpërhapjes së gjuhës shqipe. Këto fjalë mbeten si amanet i rilindësve për ruajtjen e kësaj gjuhe sa të lashtë, aq edhe të vyer.

Mërgimtari e lë vendin e tij duke mbajtur kokën mbrapa dhe me dhimbje për vendlindjen. Një gjë të tillë e thekson edhe Konica kur thotë: *“Duhet të jesh jashtë Shqipërisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç'forcë e ç'bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri!”*.

*“Historia e një gjuhe është historia e popullit që e flet”*, shkruan patriarku i shqipes dr. Eqrem Çabej.

Për disa mërgimtarë ndjenja e pasigurisë në vetvete shkakton një krizë identiteti, ku individi ose vendos të ruajë me krenari identitetin e vendit amë dhe të mësojë karakteristikat e identitetit të vendin pritës, ose, nga pasiguria që e shoqëron, kërkon të përqafojë me çdo kusht identitetin e vendit pritës duke neglizhuar identitetin e vërtetë të vendit amë. Dhe kjo është e dhimbshme!



Kjo do të thotë se çdo emigrant e zgjedh vetë nëse do të njihet si një qytetar global që është krenar për trashëgiminë e tij të shkëlqyer shqiptare, apo të kthehet në një endacak qyqan, pa një identitet të vetin dhe me një identitet karikaturë të stisur të vendit pritës.


Ky është misioni ynë si MËSUES në diasporë: t'i ndihmojmë mërgimtarët të bëhen qytetarë globalë, të cilët janë krenarë për trashëgiminë e tyre të shkëlqyer shqiptare, e të bëjmë një “*brain gain*” për vendin amë duke mos lejuar që vëllezërit dhe motrat tona të kthehen në endacakë qyqanë nëpër dyert e botës.

Të nderuar kolegë, 7 Marsi na kujton dhe një herë se të gjithë së bashku, pa dallime të çdo lloji, të punojmë pandashëm për të ngritur prestigjin kombëtar e ndërkombëtar të shqipes amë, ta vitalizojmë e ta latojmë atë, ta pastrojmë e ta pasurojmë, ta bëjmë të qëndrojnë e dinjitetshme krah simotrave të veta në pemën e gjuhëve indoevropiane, duke realizuar ëndrrën rilindëse dhe vetë përpjekjet e synimet e Mësonjëtores së Parë apo Shkollës së Vashave në Korçë, më 1887.

Ruajtja e gjuhës është detyrë e shenjtë për çdo shqiptar dhe së bashku mundemi ta ruajmë ashtu si e trashëguam nga të parët tanë.

Duke ju falënderuar për punën tuaj fisnike dhe si mësuese, me lejoni t'ju uroj 7 Marsin, duke ndarë me ju amanetin që na vjen nga rilindësit tanë:

Porsi kanga e zogut t'verës,  
qi vallzon n'blerim të prillit;  
porsi i ambli flladi i erës,  
qi lmon gjit e drandofillit;  
porsi vala e bregut t'detit,  
porsi gjâma e rrfës zhgjetare,  
porsi ushtima e nji tërmetit,  
ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare...



Pra, mallkue njai bir Shqyptari,  
qi këtë gjuhë të Perëndis',  
trashigim, që na la i Pari,  
trashigim s'ia len ai fmis;  
edhe atij iu thaftë, po, goja,  
që përbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,  
flet e t'veten e lèn mbas dore...

Prandaj, pra, n'e doni fisin,  
mali, bregu edhe Malcija  
prej njaj goje sod t'brohrisim:  
Me gjuhë t'veten rrhoftë Shqypnia!

*Gjergj Fishta*



Në pamundësi që të gjithë pjesëmarrësit të flasin, Këshilli Organizativ i programit “Lule për mësuesit” pranë KKAD-së kërkoj nga të gjithë të pranishmit, që përmes shkrimit, të paraqesin kërkesën e tyre.

Këshilli Organizativ i mblodhi të gjitha shkresat e mësimeve, të cilët kanë dhënë mendimet e tyre, ne do t'i publikojmë në librin elektronik.

Te shumë mësime/e kemi bërë ndërhyrje tek germa –*ë*– dhe te disa gabime teknike dhe gjuhësore, po që nuk kemi prekur strukturën e fjalisë, e kemi ruajtur ashtu si është shprehur.

- 18:54:05 **Irena:** Mirëmbërëma të gjithëve
- 18:54:42 **B. Beqiri:** Shkolla SHQIP Dueville VI /Itali
- 18:54:48 **Jerida Kulla:** Përshëndetje!
- 18:54:48 **Drenusha:** Përshëndetje!
- 18:55:08 **Osman Ademi:** Përshëndetje! Osman Ademi Vjenë Austri
- 18:55:09 **Kristina Roshi:** Përshëndetje të gjithëve!
- 18:55:21 **Valbona Toci:** Mirëmbërëma të gjithëve. Valbona Toci shkolla Shqipe Bologna
- 18:55:26 **Irena:** Jam Irena mësuese e shkollës shqipe “Parashqev Qiriazi” Trieste
- 18:55:32 **Armenda Amiti:** Përshëndetje të gjithëve
- 18:55:32 **Adriana Bejko:** Përshëndetje nga Kanadaja të gjithëve
- 18:55:43 **Miradije Berishaj:** Përshëndetje nga Austria
- 18:55:50 **Merve Yildiz:** përshëndetje nga Turqia
- 18:55:53 **Merita Ymeri:** Përshëndetje të gjithëve të nderuar kolegë!
- 18:56:00 **Kristina Roshi:** Quhem Kristina Roshi!
- 18:56:01 **Mimoza Dako:** unë ju dëgjoj, por nuk ju shoh
- 18:56:04 **Vaxhid Sejdiu:** Përshëndetje nga Zvicra
- 18:56:06 **Eva Krypca:** Përshëndetje të gjithëve!
- 18:56:11 **Merita Ymeri:** Përshëndetje të gjithëve të nderuar kolegë!
- 18:56:13 **Musa Pali:** Përshëndetje të gjithëve Musa Pali Zvicër- Ulqin
- 18:56:14 **Leonora Zefi:** Përshëndetje nga Trento (IT)
- 18:56:15 **Maniola Tzagianka:** Përshëndetje të gjithëve!
- 18:56:26 **Auror:** Mirëmbërëma Nga USA.
- 18:56:26 **Drenusha:**  
Urime festat e Marsit, në veçanti 7 Marsi “Dita e Mësuesit”. Drenusha Istogu – Shkollë Shqipe - Rosenheim
- 18:56:31 **S Halilaj:** Mirëmbërëma!
- 18:56:40 **Mendu Imeri:** Përshëndetje nga Kroacia
- 18:56:42 **Gerti Xhaja:** Përshëndetje të gjithëve nga Stokolm, Suedi!
- 18:56:42 **Ardjan Shaqiri:** Përshëndetje të gjithëve
- 18:56:45 **Nicola d'angelo:** Mirëmbërëma të gjithëve Mimoza Sali Paris
- 18:56:51 **Sarah:** Përshëndetje nga Athina:
- 18:56:52 **S Halilaj:** Mirëmbërëma!
- 18:56:53 **Mësues Flamur Biçaku Patra Greqi:**  
Përshëndetje te gjithëve nga Flamur Bicaku nga Patra e Greqisë



- 18:57:00 **Esmeralda Sadiku:**  
Mirëmbërma! Jam Esmeralda Sadiku, mësuese e shkollës shqipe "Artur Lleshi", Bolzano Itali.
- 18:57:07 **S Halilaj:** Sadete Halilaj Nga Londra
- 18:57:13 **Hamez Dakaj:** Përshëndetje të gjithëve
- 18:57:13 **Përdorues:** Përshëndetje nga Elida Halilaj / Shkodër/Shqipëri.
- 18:57:16 **Mendu Imeri:** Mendu Imeri, mësues i mësimit plotësues në gjuhën shqipe:  
1. Shkolla fillore "Svete Ane" në Osijek, Republika e Kroacisë  
2. Shkolla fillore "Vijenac" në Osijek, Republika e Kroacisë  
3. Shkolla fillore "Ivan Goran Kovačić" në Đakovo, Republika e Kroacisë  
4. Shkolla fillore "Velika Pisanica" në Velika Pisanica, Bjelovar, Republika e Kroacisë.
- 18:57:18 **Flora:** Urime për festën e 7 Marsit, nga Madridi.
- 18:57:21 **Kristina Roshi:** Krustina Roshi, mësuese tek "Shtëpia Shqiptare Porta, " Greqi!
- 18:57:27 **BORALDA PAPAGIANNI:** Përshëndetje të gjithëve!!!!
- 18:57:33 **Pjerin Lleshi:** Mirëmbërma dhe përshëndetje të gjithëve!
- 18:57:35 **Diti:** Përshëndetje!
- 18:57:37 **Mendu Imeri:**  
Të nderuar kolege, në këtë ditë të shenjtë për kombin tonë pranoni urimet më të përzemërta me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit.  
Me respekt, Mendu Imeri, mësues.
- 18:58:03 **Eleni spahiu:** Përshëndetje të gjithëve! Eleni Licaj Spahiu shkolla shqipe "Dritëro" Merano, Itali.
- 18:58:26 **Bona Mara:** Përshëndetje! Jam Valbona Mara mësuesja e gjuhës shqipe ne qytetin e Kavalës në Greqi.
- 18:58:32 **Valentina Coli:** Përshëndetje të gjithëve, urime festa e 7 marsit.
- 18:58:34 **Alma Papamihali:** Përshëndetje për Steckl
- 18:58:44 **Vaxhid Sejdiu:**  
Shkolla Shqipe Zvicër: Gëzuar Festën e 7 Marsit kolegë të nderuar kudo ku jeni!
- 18:58:48 **Eneida Beshaj:**  
Përshëndetje të gjithëve, nga Elvira Beshaj, shkolla shqipe në Luxembourg.
- 18:59:27 **Gerti Xhaja:** nuk po e dëgjojmë videon
- 18:59:32 **Boralda Kuci:** Përshëndetje nga Boralda Kuçi! Mësuese e Gjuhës Shqipe, Bern Zvicër.
- 18:59:47 **Xhevat Isufi:** Përshëndetje, mua nuk më lejohet ta përdori mikrofonin. Respekt
- 18:59:53 **Teuta:** Përshëndetje jam Teuta Myrtaj, mësuese e gjuhës shqipe në Zvicër
- 18:59:55 **MAJLINDALIPI:** Përshëndetje !Majlinda Lipi, Katerini!
- 18:59:56 **Pjerin Lleshi:** Mirëmbërma dhe përshëndetje të gjithëve!
- 19:00:03 **Ekloida Canellari:** Përshëndetje ! Gëzuar 7 Marsin ! Ekloida Canellari Selanik
- 19:00:08 **Valentina Coli:** Valentina Coli - shkolla shqipe Garching
- 19:00:14 **Esonela Zekthi:**  
Përshëndetje të gjithëve! Jam Esonela Zekthi shkolla "Udha e shkronjave" Asti.  
Gëzuar festën.
- 19:00:16 **Musa Pali:**  
7 Marsi "Dita Kombëtare e Mësuesve" Sakrifika e mësuesëve dhe mësuesve nëpër dekada ka mbajtur gjallë gjuhën shqipe dhe arsimin shqip në Shqipëri,

Kosovë, në viset tjera etnike dhe kudo që kanë emigruar shqiptarët në botë. Në këtë ditë të shenjtë të 7 Marsit, nderojmë mësuesit dhe mësueset për punën dhe kontributin e madh që kanë dhënë, që po japin e që do të japin, për mësimin dhe kultivimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në tërë botën. Sot, mësimi në gjuhën shqipe zhvillohet pothuaj në të gjitha shtetet e planetit të rruzullit tokësor, aty ku ka shqiptarë aty ku flitet e shkruhet lirshëm, falë mësuesve shqiptarë. Detyra jonë sot është ta përcjellim frymën tonë të përkushtimit dhe punës me pasion, ashtu të pastër te brezat e ardhshëm në mënyrë që gjuha shqipe të mos pushojë së foluri. Në këtë ditë të veçantë, Ju urojmë Ditën e 7 Marsit e cila njihet si “Dita Kombëtare e Mësuesve” dhe që sot mbushen 134 vite nga krijimi i Mësonjëtores së parë shqipe në qytetin e Korçës. GËZUAR 7 MARSIN

- 19:00:32 **Alma Papamihali:** Pershendetje dhe Gezuar festen e Mësuesit .Alma na Ger
- 19:00:39 **BORALDA PAPAGIANNI:** Jam Boralda Papajani mësuese vullnetare pranë Organizatës "Jeta" në Athinë.
- 19:00:58 **Zhuljeta Kobellari-Hysolli:** Mirëmbërma! Jam Zhuljeta Kobellari-Hysolli nga shkolla "Fari i dijes", Hania, Greqi.
- 19:02:08 **Antoriata Hysolli:** Përshëndetje, Antoriata Hysolli mësuese e mësimin plotësues në shkollën fillore, Mainburg.
- 19:02:15 **VIOLETA:** Përshëndetje dhe Gëzuar festën e Mësuesit, Violeta, Greqi
- 19:02:37 **Diana:** Përshëndetje, jam Diana Muca Hanxhari, mësuese në shkollën shqipe të Leccos Itali
- 19:02:38 **Brunilda Toshkesi:** Përshëndetje! Gëzuar 7 Marsin! Brunilda Toshkesi, Selanik
- 19:02:40 **BORALDA PAPAGIANNI:** Kam shume kënaqësi t'iu përshëndes dhe t'iu uroj të gjithëve Gëzuar festat e 7-8 Marsit!!!
- 19:02:50 **Xhevat Isufi :** Nuk ju dëgjoj???
- 19:03:21 **Miradije Berishaj:**  
Miradije Berishaj, mësuese e gjuhës shqipe në Vjenë - Austri, kryetare e SHMSH “Naim Frashëri” dhe anëtare e KKAD. Kam nderin kolegë/e, mësues/e kudo që punoni në Atdhe e në Diasporë t'ju përshëndes në këtë ditë të veçantë dhe t'ju uroj për zemërsisht “7 Marsin - Ditën e Mësuesit”, për kontributin e madh që kanë dhënë dhe po jepni në ruajtjen e gjuhës, dhe kulturës shqipe.
- 19:03:31 **35385:** Përshëndetje të gjithëve - Liljana Picari (Dublin, Irlandë)
- 19:03:42 **Drita Gjongecaj:** Gëzuar 7 Marsin të gjithë kolegëve!
- 19:03:53 **Boralda Kuci:** Një thënie e huaj thotë " Vlera e mësuesit dhe pesha e qiellit nuk maten kurrë" Gëzuar 7 - Marsin mësues kudo jeni!
- 19:03:58 **Sonila Otobashi:**  
Mirëmbërma! Jam Sonila Otobashi, mësuese e shkollës shqipe të shoqatës "Scanderbeg" në Parma te Italisë. Gëzuar festën e mësuesit!
- 19:04:00 **Amanda Hoti:** Përshëndetje të gjithëve! Gëzuar 7 Marsin! Amarda Ekmekçiu mësuese e gjuhës shqipe, Athinë!
- 19:04:04 **B. Beqiri:** B. Beqiri shkolla SHQIP Dueville VI /IT. Gëzuar 7 Marsin të nderuar!
- 19:04:08 **Dritan Mashi:** Përshëndetje nga Trento, Itali
- 19:04:13 **Blerina Shabani Morina:** Blerina Shabani Morina
- 19:04:21 **Sarah:** Jam Majlinda Gjoka mësuese në Athinë. Urime të përzemërta, dashuri e vlerësime pafund për punën e çdo mësuesi!
- 19:04:29 **Musa Pali :** GËZUAR 7 MARSIN! Musa Pali shkolla Shqipe në Vevey Zvicër

- Kantoni Vaud, ku shërbeva më se 25 vite në mësimdhënie në këtë shkollë. Prej vitit 2019 jam në pension. Anëtar i KKAD-së ( Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë)
- Faqja e Shkollës Shqipe në Vevey Zvicër:
- 19:04:53 **Blerina Shabani Morina:** Shkolla shqipe në Holzkichen-Gjermani!
- 19:04:53 **Antoneta Micalliu:** Mirëmbërëma!
- 19:05:04 **Eeleni Spahiu:**  
Gëzuar festën gjithë mësuesve! Suksese në misionin më fisnik!  
Suksese në profesionin më të bukur nën diell! Urime dhe respekt! Nga mësuesja e gjuhës shqipe Eleni Liçaj Spahiu. Merano, Bolzano Itali.
- 19:05:24 **Pjerin Lleshi:**  
Jam Pjerin Lleshi, mësues vullnetarë, në Athinë. Ju uroj nga zemra  
Gëzuar 7 marsin, të gjithë mësuesve, kudo që ndodhen!
- 19:05:29 **Lindita Vendresha:** Mirëmbërëma të gjithë të pranishmëve!
- 19:05:30 **Imer Ademi:** Përshëndetje të gjithëve duke ju uruar 7 Marsin Dita e Mësuesit!
- 19:05:32 **Blerina Shabani Morina:** Blerina Shabani Morina Shkolla shqipe në Holzkichen - Gjermani!
- 19:05:33 **Dila Rrapi:** Mirëmbërëma! Dila Rrapi, mësuese pranë shoqatës "BESËLIDHJA" Rovereto Tn Itali! Gëzuar festën e 7 Marsit!
- 19:05:57 **Shkurte Shala:**  
Gëzuar ditën tuaj, mësues të dashur nga Vjena, nxënësja Anisa Shala klasa e 2 Jagdgasse. E në veçanti e falënderojmë mësuesen Miradije Berisha për kontributin e dhënë në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqipe. Ju jemi shumë mirënjohës për punën tuaj të palodhur.
- 19:06:08 **Enilda Ganolli Progni:**  
Përshëndetje. Gëzuar 7 Marsin të gjithë mësuesve të kudondodhur
- 19:06:58 **Lindita Vendresha:**  
Jam Lindita Vendresha mësuese vullnetare në Athinë. Gëzuar në këtë 7 Mars kaq të veçantë!
- 19:07:00 **Rezearta Dizdari:** Përshëndetje
- 19:07:30 **Raimonda Deda:**  
Përshëndetje jam mësuese Raimonda shkolla Zëri Atdheut Montebelluna, Itali  
“Puna e një mësuesi është sikur e një qiriu që djeg veten dhe u jep dritë të tjerëve  
“urime 7 Marsin të gjithëve.
- 19:07:41 **Mimoza Dako :** Përshëndetje të gjithëve!  
Ju uroj Gëzuar festën e 7 Marsit!  
Le të jetë kjo ditë pikënisja e bashkëpunimit dhe e mirëkuptimit në shërbim të gjuhës shqipe! Suksese e mbarësi kudo që jeni!  
Me respekt  
Mimoza Dako,  
mësuese e gjuhës shqipe ( Shkolla Shqipe-Zvicër)  
Anëtare e KKAD
- 19:07:43 **Danila Sfaga:**  
Mirëmbërëma të gjithëve ! Nga mësueset e shkollës “Udha e shkronjave”, ASTI.  
Madalena Peshtani, Danila Sfaga e Esonela Zekthi.
- 19:07:46 **Talat Pllana:**  
Talat Pllana drejtor i Shkollës Shqipe, Kosova, në Londër, përshëndetje për gjithë

19:08:01

mësueset e shkollave shqipe në Diasporë. Gëzuar Dita e Mësuesit 7 Marsi për gjithë mësuesit shqiptarë kudo qofshin!

**Teuta:**

Gëzuar të gjithë mësuesve që punojnë brenda dhe jashtë Atdheut në shërbim të arsimimit të brezit të ri. Veçanërisht në Diasporë ku ruajtja e gjuhës amtare është përparësi. Gëzuar!

19:08:44

**Aida Haziri:** Përshëndetje nga Londra. Aida Haziri nga Londra. Ju uroj gëzuar Festën e 7 Marsit.

19:09:33

**Xhevat Isufi:** Unë nuk po ju dëgjoj?

19:09:44

**Lindita Budini:** Përshëndetje nga Selaniku! Lindita Budini. GEZUAR FESTËN E MËSUESIT!

19:09:49

**Mësues Flamur Biçaku Patra Greqi:**

Gëzuar 7 Marsin një urim për të gjithë kolegët në Diasporë dhe kolegëve tanë në Shqipëri.

19:10:00

**Renata Durro:** Përshëndetje të gjithëve!

Gëzuar 7 Marsin, kolegë të nderuar!

Gëzuar, ju, njerëz të përkushtuar, që bëni të pamundurën që nxënësit të trashëgojnë dije, gjuhën dhe kulturën e atdheut.

Ju përshëndes me respekt, Renata Duro, mësuese e gjuhës shqipe, në "Shtëpia Shqiptare Porta" Athinë, Greqi.

19:10:56

**Merita Isufi:**

Lule për mësuesit! Një ide e bukur, urime organizatorëve. Gëzuar 7 Marsin të gjithë mësuesit kudo që ndodhen, veçanërisht juve në këtë zoom. Me respekt Merita Isufi nga Londra!

19:11:02

**Anila Kadija:** Ju përshëndes të gjithëve. Anila Kadija, Londër

19:11:22

**Lindita Budini:** Përshëndetje Mira! Sa gëzim të shoh!

19:11:36

**Xhylizade Misini:** Përshëndetje nga Franca. Xhylizade Misini Ju uroj Gëzuar Festën e 7 Marsit.

19:11:36

**Merita Ymeri:** Të nderuar kolege/ë, në këtë ditë të veçantë për të gjithë ne sot, uroj Gëzuar festën e 7 Marsit të gjithë mësuesve kudo ndodhen në Shqipëri e Diasporë! Merita (Hida) Ymeri, mësuese vullnetare e mësimit plotësues gjuha shqipe kurset; Kallabaka, Vasiliki, Trikalla, Selanik pranë shoqatës "Drita e Diturisë" dhe shoqatës "Progresi" në Greqi. Momentalisht me banim në Stockholm Suedi prej disa muajsh. Ju uroj suksese dhe Gëzuar!

19:12:05

**Enilda Ganolli Progmi:**

ENILDA GANOLLI PROGMI mësuese e mësimit plotësues të gjuhës shqipe në ishullin e Salamines Greqi. Gëzuar festën e mësuesit

19:12:17

**Lira Ndrio Bakalli:**

Mirëmbërëma të gjithëve!

Mirë se u mblodhëm!

Gëzuar 7-8 Marsin!

19:13:17

**Përdorues:** Gëzuar festën të dashur kolegë, mësues në Diasporë!

19:13:46

**Zyryfa:** Përshëndetje për të gjithë, Zyryfa Kqiku nga Londra, ju uroj Gëzuar 7 Marsin!

19:14:34

**Antoriata Hysolli:** Gëzuar festën e 7 Marsit, suksese të gjithë mësuesve dhe të gjithë nxënësve shqiptare në mbarë botën!

- 19:14:51 **Marjana Shollo:** Gëzuar 7-8 Marsin! Një urim i përzemërt nga grupi mësimor i shkollës “Fari i Dijes”, Hania, Kretë-Greqi.
- 19:16:13 **Keti Bandilli:**  
Përshëndetje nga shkolla shqipe “Fari i Dijes” në Hania të Kretës, Greqi. Gëzuar të gjithëve festa e 7 Marsit dhe ju përgëzojmë për këtë organizim të vlefshëm. Gëzuar të gjithë kolegëve në mbarë botën.
- 19:17:14 **Armenda Amity:** Gëzuar 7 Marsin të gjithëve! Armenda Amity Slloveni.
- 19:17:18 **Maniola Tzagianka:**  
MANJOLA XHAJANKA: Mësuese, vullnetare pranë Organizatës JETA në ATHINË, TË dashur kolegë, Ju Përgëzoj për Ditën e Mësuesit!! Ju uroj frymëzim, sa më shumë ide interesante në misionin e artë të mësimdhënies!
- 19:18:02 **Teuta:** Kontributi yt si atdhetarë mësues i gjuhës shqipe ne diasporë është i pallogaritshëm Zoti Vaxhid Sejdiu.
- 19:19:11 **S Halilaj:** Gëzuar 7 Marsin 'Përhapësit e dritës (L.G.)' Sadete Halilaj (mësuese në Londër)
- 19:20:20 **Rinor Thaqi:** Përshëndetje
- 19:21:10 **Flora:** Të dashur miq, mësues, kolegë kudo që jeni ju përshëndes unë, Flora Andona Sallabanda nga Madridi, mësuese e përfaqësuese e shkollës së parë këtu në Spanjë. pres që të kalojmë një pasdite frutdhënëse në vazhdimin e punës tonë.
- 19:21:21 **VIOLETA:** Violeta Skopeci – Selanik – Shoqata “Progresi” shkolla Petrino, Stavrupoli
- 19:22:05 **BORALDA PAPAGIANNI:**  
Shpresojmë dhe urojmë që vitin tjetër të takohemi ballë për ballë dhe jo në mënyrë virtuale. Ju faleminderit shumë për ftesën .Edhe njëherë Gëzuar festën kolege te dashur kudo qe jemi! Nga Athina Boralda Papajani.
- 19:24:21 **Silvana Mile:** Silvana Mile mësuese vullnetare, Organizata Jeta ne Selanik. Uroj të gjithë mësuesit Shqiptare në mbarë botën gëzuar 7 Marsin.
- 19:24:48 **Lefteri metkaj:**  
Përshëndetje i nderuar z.Vexhit Sejdiu dhe kolege, ju jeni Pishtarë të dijës ne Diasporë ! Urime nga Lefteri Metkaj, mësuese e gjuhës shqipe ne Athine- Greqi!  
Arsimi shqip jashtë Atdheut është çështje kombëtare.  
Historia na ngarkoi ne kohet moderne të kryejmë misionin me te rëndësishëm kombëtar, mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët e emigranteve në diasporë dhe ne te pandare po e kryejmë me devotshmëri, këtë mision, sepse dashuria për gjuhën shqipe është brenda nesh.  
Rroftë Shqipëria dhe Gjuha Shqipe !
- 19:24:53 **Milazim Ukaj - LAPSH Bavari:**  
Të nderuar kolege/ë, urime festën e „7 Marsit – ditës së Mësuesit“ të gjithë mësuesve kudo që ndodhen, në Atdhe dhe Diasporë!  
Milazim Ukaj, Kryetar i Lidhjes së Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptare në Bavari
- 19:26:15 **1801 iPad:**  
Të dashur bashkatdhetarë/ re, mësues, kolege, miq kudo që ju jeni, ju përshëndes nga Gjermania, GËZUAR 7 MARSIN MËSUES TË DASHUR!
- 19:27:07 **Majlinda Lipi:** Të nderuar kolegë ! Gëzuar 7 Marsin, festën e mësuesit! Majlinda Lipi, Kursi i Gjuhës Shqipe Katerini, Greqi
- 19:32:33 **Leonora Zefi:**  
Përshëndetje nga Shoqata e Shoqata e Grave Shqiptare ne Trento “TEUTA” e themeluar ne 2008, e cila ne shtator 2009 ka hapur kursin e gjuhës shqipe për





fëmijët e emigrantëve shqiptar ne këtë zone. Por përhapjen e gjuhës shqipe nuk behet vetëm nëpërmjet kurse për fëmijët tanë, por edhe me futjen e librave shqip ne bibliotekat e vendeve ku jetojmë. Ne kemi filluar ne 2018 me bibliotekën e Trentos. Kemi nevojë për libra për t'i shpërndarë ne bibliotekat e tjera rajonale. Jemi te lumtura qe institucionet shqiptare po interesohen për përhapjen e gjuhës shqipe jashtë trojeve të shqipfolësve

Ju përshëndesim dhe ju urojmë! Gëzuar Ditën Kombëtare te mësuesve!

Për Shoqatën “Teuta”, Trento mësuesja e gjuhës shqipe, Leonora Zefi

19:32:38

**Teuta:** Faleminderit Zonja Mimoza Hysa per mbeshtetjen qe Qendra e Botimeve per Diasporën ju jep mësuesve të diasporës. Teuta Myrtaj Zvicer.

19:33:21

**Musa Pali :**

Mësueses sime Mësuesja ime më mëson mirë, Ajo është e mrekullueshme dhe e dëlirë. Është serioze dhe shumë e lirë. Ajo më mësoj të shkruaj dhe të lexoj, Të shkruaj bukur të shprehem lirë e të këndoj, Më mësoj të kryej operacione në matematikë. Me gëzim dhe me hare për çdo ditë.

Në orë të caktuar dhe me punë pa përtim, Ti më ndihmove ta respektoj çdo disiplinë. Si në klasë ashtu edhe në oborr.

Ma shtove dashurin për vendin tonë. Ti më ndihmove ta dua natyrën, Si ta respektoj dhe ta ruaj pastërtinë, Dhe ti mësoj të tjerët ta heqin ndotësinë.

Më ndihmove ti zgjedh problemet, Të ruhem nga të papriturat rreziqet. Që çdo çast ata na kërcënojnë në shtigjet. Isha shumë i kënaqur që të kisha mësuese. E bukur dhe e dobishme si një perëndeshë.

I lutem zotit me gjithë zemër e përherë,

Që një ditë të bëhem si ajo me nderë,

Plotë guxim dhe punë me vlerë.

MUSA PALI

ZVICËR

19:34:03

**Ekloida Canellari:**

Ekloida Canellari Organizata Jeta Selanik ! Ju përgëzoj për këtë takim, suksese dhe shume urime të gjithë kolegeve për punën e tyre! Ju faleminderit për ftesën!

19:35:11

**Michele Greco:** Mirëmbërëma vëllezër dhe motra shqiptare, përshëndetje nga arbëreshët dhe Kalabrisë dhe nga Michele Greco.

19:36:08

**Gerti Xhaja:**

Përgëzime për këtë bashkëpunim me institucionet arsimore te Kosovës.

Mendoj se ka shume për te mësuar prej tyre, përsa i përket kujdesit dhe përkrahjes së arsimit te gjuhës amtare dhe aktivitet kulturore për te mbajtur gjalle gjuhen dhe kulturën shqipe të fëmijët ne diaspore. Te paktën nga përvoja ne Suedi!

19:37:03

**Lindita Budini:** Faleminderit zysh Adriana

19:37:18

**Merita Isufi:**

Është privilegj te jesh mësuese në Diasporë dhe kudo në trojet shqiptare.

Fëmijët kanë të drejtë të dinë dhe të kuptojnë identitetin kulturor të tyre. Kjo është e drejta themelore e njeriut. Humbja e gjuhës sonë tek humbja e identitetit kulturor, dhe mbart me vete shume implikime te rrezikshme. Gjuha është thelbësore në shprehjen e kulturës. Ne zhvillojmë ndjenjën se kush jemi bazuar ne atë që është reflektuar nga familja, mësuesit, shoqëria dhe mediat. Këto të gjitha kane një ndikim te madh ne formimin e identitetit. Nëse mësojmë gjuhën, i japim vlere





19:38:03

kulturës dhe respektojmë rrënjët tona, e kemi edhe me te lehte te respektojmë edhe kulturat e tjera dhe te integrohemi ne shoqërinë ku jetojmë. Mësuesit janë role model dhe motivuesit me te mire për te gjithë nxënësit. Vlerësimi me i mire vjen nga fëmijët, kur kjo detyre është kryer me dashuri dhe pasion. Respekt për të gjithë mësuesit kudo qe kontribuojnë për këtë detyre të rëndësishme dhe me shume përgjegjësi. GËZUAR 7 MARSIN! Mirënjohje nga Merita Isufi Londer

**Rinor Thaqi:**

Ragip Thaqi nga shkolla shqipe në Bassano del grappa në kuadër të Shoqatës kulturore "Bashkimi kombëtar" urime 7 marsi për zemërsisht nga shkolla jonë dhe shoqata jonë duke dëshiruar qe mësimi i gjuhës shqipe ne diaspore te perfishihet nga te gjithë femijet ne diaspore. Urojmë që çdo fëmijë i lindur në migrim të bëhet pjesë e shkollës shqipe në Diaspore! Përgëzoj çdo mësues që është pjesë e rrugëtimit të ruajtjes së gjuhës shqipe në Diaspore. Me që jam kryetar i KMSH në Vneto: Gëzuar 7 marsin edhe në emër të Këshillit të Mësuesve Shqiptarë në rajonin e veneto-s!

19:39:22

**Luljeta Çobanaj:**

Nga Luljeta Çobanaj Kordinatore Diasporës pranë Konsullatës së Përgjithshme Milano

19:40:37

**Osman Ademi:**

Të nderuara kolege, të nderuar kolegë të mësimit plotësues në mërgatë!  
Ju jeni ata që me punën tuaj, me dijen tuaj, të cilën po e shpërndani si rreze dielli kudo nëpër botë, ju që mbani gjallë gjuhën dhe kulturën shqiptare tek fëmijët shqiptarë, të cilët janë ardhmëria e vendit tonë! Sot është festa juaj, festa jonë e përbashkët, dita kur filloi të ndahet drita nga errësira, andaj me plot krenari ju themi: Gëzuar "7-Marsi- Dita e Mësuesit"! Uroj që të kemi sa më shumë fëmijë që ndjekin rrugën e dijes dhe kulturës shqiptare!

Osman Ademi - Mësues në Vjenë, Austri

19:41:07

**Melita:** Gëzuar 7 Marsin kolegë të nderuar! Melita Orešković, mësuese e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Shkollën Tetëvjeçare në Zagreb, Kroaci.

19:41:13

Qemal Zylo: Përshëndetje te gjithëve në emër të Shkollës Shqipe "Alba Life" në USA dhe në emrin tim personal si anëtar i KKAD-së. Me respekt te gjithë mësueseve kudo që janë për punën e bërë dhe Gëzuar 7 Marsin! Me respekt Qemal Zylo

19:41:57

**Eva Krypca:** Gëzuar 7 Marsin të nderuar kolege! Nga Eva Krypca, Kaufbeuren-Gjermani.

19:43:52

**Elida Halilaj:** Fjala MESUES shkruhet me shkronja të mëdhaja . Bravo Adriana! Gëzuar 7 Marsin!

19:45:32

**Esmeralda Sadiku:** "Një komb zhvillohet në bazë të gjuhës së tij, se në gjuhë të huaj tretet". Gëzuar 7 Marsin ju uroj të gjithë kolegëve të mi, përcjellës të gjuhës e kulturës shqipe Esmeralda Sadiku, Bolzano, Itali

19:46:20

**Blerina Shabani Morina:** Përgëzime për idenë Lules për Mësuese! Gëzuar 7 Marsi të nderuar mësime dhënë! Blerina Shabani Morina nga Holzkichen-Gjermani

19:46:26

**Lefteri Metkaj:** Përshëndetje e nderuar znj Adriana Bejko! Mesazhi yt është imazhi i bashkimit. Shumë herë jeni bërë frymëzim ne punën time në Athinë!

19:46:51

**Fatmire Bunjaku:** Gëzuar 7 Marsin

19:47:05 **Merita Ymeri:** Shumë e nderuar profesore Adriana, më mallëngjyet me këto fjalë. Ky është leksioni më i bukur që kam dëgjuar!

Gëzuar nga zemra!

19:47:17 **Luljeta Çobanaj:** Gëzuar nga zemra e respekt të veçanta për 7 Marsin të gjithë mësuesve shqiptare kudo që janë, të dy motrave te mia mësuese, qoftë ky Këshill Koordinues i Arsimitareve ne Diaspore, hapi i pare për te lënë shenjë në këtë udhëtim të veçantë, të Alfabetit tonë në të gjithë rruzullin tokësor. Si kurrë me parë gjuha jonë është përhapur kudo, e merite e veçantë për ju mësues, për ju nena që kane bere te mundur që fëmijët tanë te përcjellin brez pas brezi ëndrrat tona. është e bukur gjuha jone. te jete ky vit i nismës “EJANI TE FLASIM SHQIP”, EJANI të flasim shqip, dhe ndërkohë dëgjoj Doktor Adriana Bejko me poezinë e Dritëro Agolli Ejani te lavdërojmë në shqip... Së bashku me gjuhën mësuesit t'u edukojnë nxënësve dashurin për njeri-tjetrin, dhe për Shqipërinë. Faleminderit mësues! Me dashuri e respekt për të gjithë ju Luljeta Cobanaj Milano

19:47:41 **Mustafë Krasniqi:** Në emër të Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë në Bavari, të gjithë mësime dhënë dhe mysafirëve të respektuar ju urojmë „7 Marsin Ditën e Mësuesit”, konkretisht edhe shfrytëzime rastin që përmes kësaj urate t'i thërrasim të gjithë mësime dhënësit, bashkëkombësit, shoqatat dhe bizneset, që jetojnë dhe veprojnë në Bavari, ta përkrahin Mësimin Plotësues në Gjuhën Shqipe, ngaqë rreziku për asimilim po vijë heshturazi , që sikur porosinë e atdhetarëve po e injorojmë me apo pa dashje. Dita e mësuesit, 7 marsi, jo vetëm që duhet ta respektojmë si ditë të veçantë, po mbi të gjitha duhet t'i japim një rëndësi më të madhe, konkretisht Të gjithë mësime dhënësit/et që japin mësim në landin e Bavaris, në emër të LAPSH ju përgëzojmë për vullnetin dhe kontributin e juaj të palodhshëm e shumë human! Andaj edhe kërkojmë, që së bashku, të rrugëtojmë rrugës së rilindësve, sepse jo vetëm që është nder, po mbi të gjitha është nevojë shpirtërore, detyrë dhe akt patriotik e atdhetar! Po ashtu respekt për të gjithë ata bashkëkombës, këshilla të prindërve, aktivistë, shoqata e biznese që po japin kontribut për ta ruajtur gjuhën, kulturën dhe traditën te fëmijët tanë, kudo që janë në botë. Urime dita e mësuesit të nderuar mësime dhënë/e! Në emër të kryesisë së LAPSH në Bavari

19:48:20 **Alma Zekollari:** Përgëzime për këtë organizim të bukur!

19:49:39 **Alma Papamihali:**

Do doja t'i pershendes koleget dhe kontribuesit e përcjelljes se gjuhës shqipe ne Diaspore, me disa vargje. Duke falënderuar organizatoret për këtë koordinim te përbashkët, iu uroj festën e 7 Marsit mësuesve së gjuhës shqipe ne Diaspore, me dëshirën për te pasur sa me shume energji dhe pasion në punën e tyre aq te vlefshme dhe humane, siç është përcjellja e gjuhës sonë, që vlen aq shume ne ruajtjen e identitetit tone brez pas brezi.

Atdhe,

Të kemi dhe s'të kemi,

Sa afër po aq larg,

Të prekim nga ku jemi,

Por mbetet fare pak.

Të shohim pa të parë,  
Dhe ngjyrën mirë ta dimë,  
Të ndodh je për t'u qarë,  
Por s'mundet pranë të vimë.

Të kemi dhe s'të kemi,  
Por kurrë shkuar vërtetë,  
Se erdhëm ketu ku jemi,  
Por gjuhën mbajtëm jetë.

Alma Papamihali  
Shoqata / Shkolla „Iliria“  
Gjermani

19:49:59 **180iIPad :**

“Një mësues i mirë është si një qiri, ai konsumon vetveten për t`ua ndriçuar rrugën të tjerëve. „Ju përshëndes dhe uroj shëndet e vetëm të mira paçi. Me shumë respekt për ju, Teuta Dervishi mësuese e Gjuhës Shqipe në NRW të Gjermanisë.

19:50:38 **Drenusha:**

Të dashur mësues, Një thënie e huaj thotë: “Vlera e mësuesit dhe pesha e qiellit nuk maten kurrë”, andaj, me rastin e 7 Marsit, Ditën e Mësuesit, si një ngjarje e rëndësishme kombëtare, kujtojmë mësuesit tanë të parë që na i mësuan shkronjat shqipe, na mësuan si ta duam kombin dhe atdheun.

19:51:31 **Teuta:** Faleminderit Zonja Adriana për fjalën tuaj te mrekullueshme. Respekte.

19:52:08 **Irena:** Mësuesi është ai të cilit prind i beson gjene me te shtrenjte qe ka: fëmijën e tij. Shteti i beson gjënë me te shtrenjte qe ka: trurin. Mësuesi është transmetues i civilizimit, ndershmërisë intelektuale e vlerave me të arta të një kombi. Gëzuar 7 marsin të gjithë kolegeve. Faleminderit për këtë mbrëmje të mrekullueshme! Irena Alushani/Mësuese e Shkolles Shqipe “Parashqevi Qiriazi” Trieste/Itali

19:52:50 **Mimoza Leka:** E nderuar kryesi e KKAD!

19:53:08 **Danila Sfaga :** Mësuesit me te mire mësojnë nga zemra e jo nga libri .  
Gëzuar 7 Marsin kolege!

19:53:16 **Mendu Imeri:**

Bashkësia shqiptare kombëtare për Sllavoni e Baranjë e cila funksionon në Prefekturën e Osijekut dhe Baranjës në Republikën e Kroacisë uron festën e 7 marsit të gjithë mësuesve që punojnë dhe veprojnë në katër anët e botës në ruajtjen e gjuhës dhe identitetit tonë kombëtar. Urime!

19:54:38 **Fatmire Bunjaku:**

Mësues, Gëzuar 7 Marsin, Ditën e Shenjtë për të gjithë JU! Fatmire Ismaili Bunjaku mësuese në Goteborg të Suedisë!

19:54:47 **Jerida Kulla:**

Përshëndetje nga kursi i gjuhës shqipe “Frang Bardhi”, Iraklio, Kretë.Një përshëndetje e ngrohtë për të gjithë ju kolegë dhe kolege, nga Jerida Kulla dhe Klarita Selmanaj.7 Marsi i sivjetshëm, është i veçantë, është 7 Marsi i përballjes së sfidave të mësimin online. Ky 7 Mars, pavarësisht kushteve, na gjen më kërkues, më

këmbëngulës në transmetimin e njohurive të gjuhës shqipe, më të dashuruar pas profesionit tonë. Si dikur, në motin e madh, 1887, kur u hap Mësonjëtorja e Korçës, edhe ne në mërgim, me të gjitha forcat, me të gjitha mjetet, përpiqemi ta mbajmë gjallë gjuhën dhe kulturën shqiptare të fëmijët e brezit të dytë. Gjatë punës sonë, në Shqipëri, kemi ndier shumë kënaqësi, kur shikonim që nxënësit tanë, dolën në jetë dhe lexojmë shkrimet e tyre në faqet e shtypit të shkruar.

Por, kënaqësia është e shumëfishtë, kur dëgjojmë këta fëmijë, që edhe pse deri diku, me theks greqisht, mundohen jo vetëm ta lexojnë gjuhën shqipe, por edhe ta ndiejnë atë.

19:55:04 **Jerida Kulla:**

E kur një fëmijë e ndien atë që lexon apo thotë, gjuha është ngulitur thellë në zemrën e tij. Do ta vazhdojmë misionin tonë, kudo që të jemi, kurdo që të jemi, pasi gjuha shqipe për ne është e shenjtë; gjuha shqipe për ne është ekzistencë.

Ta gëzojmë këtë ditë!

19:56:31 **Ardjan Shaqiri:**

Mirënjohje gjithë Kolegëve kudo që ndodhen për kontributin dhe përkushtimin në këtë mision të përbashkët ...Gëzuar dhe Suksese

19:57:21 **Gerti Xhaja:**

Mësuesi i Gjuhës Amtare, me shume se një profesion është një mision fisnik dhe kombëtar! Ju përgëzoj të gjithëve për veprën tuaj në këtë mision për të ruajtur gjuhën dhe kulturën shqiptare dhe forconi identitetin kombëtar të të gjithë fëmijët që për arsye të ndryshme dhe jo për zgjedhje të tyre, ndodhen në një vend të huaj!

Gerti Xhaja, mësues i gjuhës amtare shqipe, Suedi!

19:57:23 **Mimoza Hysa:** Kënaqësi të ishim bashke në këtë ditë të shënuar: GEZUAR!

19:58:17 **Lindita Budini:**

Suksese të gjithë mësuesve! Faleminderit për këtë iniciative kaq inkurajuese për misionin tonë!

19:58:21 **Blerta Hoxha Ora Shqip Trieste:**

Blerta Hoxha Ora Shqip Trieste përshëndet me sloganin e saj në ditën e mësuesit ORA SHQIP/ KUDO QE NDODHEMI SHQIP / FLET VETEM SHQIP Gëzuar! Doja gjithashtu të citoja disa rreshta të BETIMIT TE MESUESIT “ Do ta kryej obligimin tim me ndërgjegje e me mburrje. Nxënësit e mi nuk do të jene vetëm nxënës, por ne rend të parë fëmijët e mi dhe kurrë nuk do ta harroj se kam nja përgjegjësi për fatin e tyre”

19:58:24 **Vaxhid Sejdiu:** Kolegë të nderuar ju faleminderit

19:58:35 **Valentina Coli:**

Mirënjohje të gjithë kolegeve, gëzuar festën e 7 marsit të gjithë mësuesve shqiptare kudo që ndodhen.

19:58:45 **Xhylyzade Misini:** Në emër të shoqatës DRITA në Laval të FRANCES GËZUAR 7 MARSIT.

19:59:19 **Teuta:**

Ju faleminderit për organizimin dhe ftesën në këtë mbrëmje kushtuar ditës së mësuesit. Gëzim i madh kur këto urime vijnë nga kolege në mbare botën. Gëzuar dhe mirë u takofshim në Tirane 7 marsin e ardhshëm.

- 19:59:31 **Mimoza Leka:**  
E nderuar Kryesi e KKD! Ju falënderoj përzemërsisht për ftesën madhështorë në këtë ditë të veçantë të mësuesit. Gëzuar festën e bukur të mësuesit. Uroj të gjithë kolegeve të mi punë të mbare në punën e tyre të mrekullueshme në të gjithë shtetet e botes. Qofshi të bekuar të nderuar kolege dhe paçi shëndet të plotë, që me mirësinë tuaj t'i shërbeni misionit tuaj fisnik dhe të ruani të gjalle gjuhën shqipe. Falënderoj në mënyrë të veçantë dr Adriana Fishta që me fjalën e saj, na dhuron shumë pozitivitet dhe na motivon në punën tonë. Me Respekt Mimoza Leka, mësuese e gjuhës shqipe në Gjermani.
- 19:59:37 **Mimoza Sali:** Urime për iniciativën e këtij takimi, sa larg dhe sa afër. Gëzuar 7 Marsin
- 19:59:48 **Kristina Roshi :** Gëzuar 7 Marsin kolegë të nderuar!
- 20:00:02 **Auror:**  
Unë sjell dhe zërin e mësuesve të tjerë nga USA që meritojnë vlerësim jo vetëm nga ana pedagogjike por dhe puna që kanë bërë në komunikim me prindërit për t'u bërë të ditur akoma dhe më shumë se gjuha dhe zakonet nuk duhen harruar. Gëzuar festat të gjithëve.
- 20:00:17 **Diti:**  
Gëzuar 7 Marsin kolegë të dashur! Ju uroj të gjitha të mirat bashkë me familjet tuaja kudo që ndodheni! Respekt të gjithëve!
- 20:00:34 **Keti Bandilli:**  
Mirë u takofshim në takime të tjera!  
Ju falënderojmë! Ishte kënaqësi! Gëzuar!
- 20:00:51 **Lindita Vendresha:**  
Gëzuar edhe njëherë! Shumë kënaqësi që u mbledhëm në këtë mënyrë duke pasur parasysh kohën që po jetojmë.
- 20:01:07 **Antoriata Hysolli:**  
Ishte kënaqësi e madhe që isha pjesë e kësaj mbledhje, faleminderit respekt, Antoriata Hysolli, pjesë e stafit pedagogjik të LAPSHit në Bavari.
- 20:02:18 **35385:**  
Faleminderit për këtë takim nga të gjithë organizatorët, folësit, fëmijët e mbi të gjitha dy mësueseve. Anila Kadija për ftesën e Adriana Bejko për mirësinë, maturinë e optimizmin që na kënaq. Punë të mbarë misionarë të shqipes nga Liljana Picari, Dublin – Irlandë.
- 20:02:26 **MAJLINDALIPI:**  
Kur sjellim nder mend punën e mësuesit, më tepër se për çdo profesion tjetër, ndofta na lejohet të ëndërrojmë, të rikujtojmë të shkuarën, të mendojmë për të ardhmen. Në shpirtin tonë ai është e kundërta e errësirës, dritësjellësi i përrallave. Ndaj, kush merr përsipër të shkruajë për mësuesin, për shkollën, ka marrë përsipër një detyrë shumë fisnike. Ndaj në këtë 7 Mars, në këtë festë të mësuesit, do të doja të uroja të gjithë mësuesit GËZUAR! TË NDERUAR E TË RESPEKTUAR GJITHMONË!
- 20:02:36 **Adriana Bejko:**  
Mirënjohje KKAD për këtë veprimtari shumë të bukur dhe kuptimplotë, Gëzohemi për ju!
- 20:03:50 **Auror:** Faleminderit Anila Kadija që më dha oportunitetin për të marrë pjesë në këtë mbledhje të mësuesve.

- 20:03:54 **Alma Zekollari:**  
Përshëndetje të gjithëve!  
Gëzuar festën e 7 Marsit të gjithë mësuese shqiptarë në botë!  
Gëzuar 8 Marsin grave, nënave, motrave kudo që ndodhen, e të cilave është shumë i rëndësishëm dhe i lidhur ngushtë punën tonë!  
Përgëzime për këtë aktivitet të bukur!  
Jam Alma Zekollari, nënkryetare e Lidhjes së Mësueseve Shqiptarë në Greqi", mësuese e gjuhës shqipe për 10 vjet në Athinë, pranë qendrës " Shtëpia Shqiptare Porta" një portë e hapur për të gjithë komunitetin shqiptar në Greqi për vite me radhë. Ju faleminderit!
- 20:04:02 **Mësues Flamur Biçaku, Patra, Greqi:**  
Edhe njëherë do desha të falënderoj të gjithë koleget e mi ne shkollën shqipe Naim Frashëri në Patra të Greqisë, për përkushtimin e pa lodhur të tyre për të mbajtur në nivelin e duhur gjuhën tone të mrekullueshme për të transmetuar të fëmijët tanë ato vlera që kemi ne si Shqiptarë, ju uroj Gëzuar Festën e 7 Marsit .
- 20:04:23 **Pjerin Lleshi:** Ishte kënaqësi që isha pjesëmarrës në këtë veprimtari të mrekullueshme!
- 20:05:20 **Brunilda Toshkesi:**  
Urime për këtë organizim! Duke ndarë këto momente së bashku në këtë ditë të veçantë!  
Gëzuar dhe suksese në misionin që kemi zgjedhur!  
Urime nga shoqata "Nënë Tereza" Selanik!
- 20:05:39 **Άρης Χάβι:**  
Përshëndetje ! Gëzuar festën e 7 Marsit të nderuar kolege kudo që ndodhëni!
- 20:11:09 **Edita:**  
Ju përshëndes të gjithëve nga Londra duke ju uruar ditën e mësuesit dhe punë të mbarë. Shpresojmë të kthehemi sa më parë në gjendje normale t'i kthehemi mësimit live pasi online ka qenë një sfidë e madhe si për ne, ashtu dhe për fëmijët.
- 20:11:33 **Moza Pojani:** Gëzuar festën të gjithëve! Përshëndetje!
- 20:11:35 **VIOLETA:**  
Ju uroj nga zemra të gjithë MESUESVE kudo që janë gëzuar festën e 7 MARSIT !  
VIOLETA SKOPECI, SELANIK, GREQI
- 20:12:31 **Enilda Ganolli Progmi:**  
Ju përgëzoj për organizimin. Ishte një kënaqësi pjesëmarrja. Ju falënderoj së tepërmi për ftesën. Gëzuar festën e 7 Marsit.  
Është obligim dhe detyrim përhapja e gjuhës shqipe nga ne mësuesit. kudo që ndodhemi
- 20:13:35 **Xhylizade Misini:** Gëzuar 7 Marsi!
- 20:14:02 **Aida Haziri:**  
Një urim shumë të madh për të gjithë mësuesit, ata që i dhanë dhe i japin dritë, frymë dhe shpirt mëndjes, dijes, kulturës dhe traditës sonë shpirtërore dhe atdhetare.
- 20:14:57 **Elida Halilaj:** Kemi dëshirë të bisedojmë gjatë; po ku ka si mësuesit.



*-Mos të harrojmë se e drejta gjuhësore  
është e drejtë njerëzore!*

*-Gjuha amtare jeton me Ne  
dhe Ne jetojmë me gjuhën amtare!*

Teuta Tabaku



# Shënim për 7 Marsin

Enela Markja  
Mësuese e gjuhës shqipe  
Starnberg, Gjermani

Ndër shumë dekada ne festojmë 7 Marsin, ku gjithmonë e më tepër rritet domethënia e kësaj dite të shënuar, sot më shumë se kurrë. Ndërkohë që numri i diasporës shqiptare vjen gjithmonë në rritje, ruajtja e gjuhës, traditave dhe kulturës sonë ndër breza është obligimi i çdo shqiptari në diasporë.

Ky 7 Mars për herë të parë në historinë e tij u organizua online - falë punës konsekuente dhe të palodhshme të KKAD-së. Mësues anë e mbanë botës nga perëndimi i Kanadasë e deri në Ukrainë, nga vendet Skandinave e deri në ishujt Egje e Kretë, të mbledhur së bashku na bashkoi një festë, një obligim, një mision.

Rrjetëzimi dhe shkëmbimi i përvojave të realizuara këto vitet e fundit evidenton nevojën e institucionalizimit dhe zhvillimit të mësimdhënies së gjuhës dhe kulturës amë në diasporë. Ky proces kërkon fuqizimin e strukturave arsimore brenda përfaqësive diplomatike të Shqipërisë dhe Kosovës, duke pajisur mësuesit me lëndë mësimore dhe kualifikuar ato.

Lexuar sot si detyrim i shoqërisë shqiptare në diasporë për ruajtjen dhe përcjelljen e gjuhës dhe kulturës shqipe, çdo nënë, baba, gjyshe e gjysh e çdo kush tjetër duhet të flasë dhe edukojë shqip fëmijët - brezin e ri.

Gjuha është element lidhës për përcjelljen e kulturës, traditave, zakoneve që na identifikon ne si komb shqiptar.

Shtrirja e diasporës mes integritimit në shoqërinë ku jetojmë dhe ruajtjes së identitetit e bën atë të mbështetet më fort në kultivimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe ndër breza.

## Anila Kadija

Të ndryshosh mentalitetin për të bashkëpunuar në të mirë të të njëjtit qëllim. Këtu qëndron edhe sekreti i të gjitha sukseseve! Nuk është fjala për bashkëpunim, por për mirëkuptim në grup. Ka një klimë të veçantë në këtë këshill profesionistësh, që shpesh është humbur nëpër shoqata apo forume të bujshme. Reflektim, punë në heshtje pa bujë mediatike personale, ide që paralelizohen apo edhe ndeshen në udhëkryq qetësisht. Eksperiencë 360 gradë prej hapësirës, aq të madhe por edhe të bukur, që ka mësimdhënia në Diasporë, mbi të gjitha dashuria dhe dedikimi, që u kushtohet dhe përkushtohet fëmijëve tanë në mësimin e gjuhës shqipe, janë veçanti që përmbledhen në katër shkronjat e KKAD-së. Nuk ka limit kohe kur ZOOM-min e nisim kryesisht në orën 21.00 dhe vazhdon biseda e shtruar deri në orët më të vona! Shpesh bëhet shaka edhe mbi këtë veçanti lidhje, me orarin e ndryshëm sipas zonës gjeografike që kemi, por me gatishmërinë për të qenë të gjithë të pranishëm. Dikush në Kanada e dikush në Itali, Greqi, Londër, New York, Zvicër, Austri, Gjermani, Kroaci, Sllovani, Turqi, duket sikur harta e botës është fokusuar mbi një pikë të vogël kuq e zi dhe flet vetëm shqip në të njëjtin moment. Nuk ka tensione apo konflikte interesash, sepse ky grup pune, i bashkuar pak për rastësi dhe pak për njohje, është personifikimi i punës vullnetare, në shërbim të komunitetit shqiptar dhe në dobi të mësimin të gjuhës shqipe përtej vendit mëmë. Këto ditë, më shumë se asnjëherë, nuk mendohet më për hapje dyersh shkollë dhe për qafime fëmijësh. As nuk po e mendojmë më atë të shkruarën në tabelë: “Mirë se erdhët, në shkollën tonë!” Përsëritet aq të dashtur, e cila gjithmonë ka qenë përçuese e entuziazmit, në ditën e parë të shkollës. Sot, “zjarri” në vatër po ndizet më shumë, koha e vështirë e izolimit ta imponon preokupimin se si do të vazhdojnë mësimet online. Diskutohet për metodat më efikase dhe për mënyrat më të mira, të cilat i përvetësuam si mësues këto muaj, kudo që ne ndodhemi, për t’ua përcjellë nxënësve tanë. Jemi të shqetësuar por me besimin, gjithmonë punët e mira dhe bashkëpunimi i sigurtë jep rezultate edhe se ka plot vështirësi për të cilat jemi të ndërgjegjshëm. Kjo është edhe arsyeja përse jam pjesë e tij!

## Aurora Doku

Mësues të dashur, për ju që me përkushtim na mësoni gjuhën e bukur shqipe, do të dëshironim t'ju dhuronim një tufë me lule të gjithëve sot, por nuk mundemi. Mundemi të mbledhim shkronjat e arta në një tufë urimi, të cilat dalin aq bukur nga zemrat tona të vogla e që ju vetë na i mësoni çdo ditë në shkollën shqipe.

Le të ndihet fort zëri i të gjithë fëmijëve shqiptarë kudo ndodhen. Mësues ne ju duam shumë! Jeni zëri i ngrohtë që na mëson të recitohet, të këndohet, të flitet në gjuhën e zemrës.

Gëzuar 7 Marsin!

